



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 17 prot.

Kamëz, më 22.02.2024

V E N D I M
Nr. 15 .Datë 22/02 2024
M B I

“MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE QË JANË REKOMANDUAR NGA ADMINISTRATORET SHOQËRORË PËR TRAJTIM ME FONDIN 6% TË BLOK-NDIHMËS EKONOMIKE”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 22.02.2024, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.12 Datë 15.02.2024, mbështetur në Ligjin 57. Date 18.07.2019 “Mbi Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” neni 21, VKM – në nr.956, datë 07.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe shërbimet shoqërore” Kreu IV, pika 2 të Vendimit nr. 955 datë 07.12.2016, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike” të ndryshuar dhe Udhëzimit nr.5. datë 17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%” të ndryshuar kreu IV, pika 3, Vendim 868. datë 29.12.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 597 datë 04.09.2019 dhe në VKB nr. 7 datë 22.01.2024 “Mbi miratimin e kriterëve për dhënien e ndihmës ekonomike gjatë vitit 2024 për familjet që nuk janë përfituese nga sistemi i pikëzimit”. Këshilli Bashkiak Kamëz;

V E N D O S I :

1. Miratimin e listës së muajit **Janar 2024**, prej 64 familje që janë rekomanduar nga administratoret shoqëror për fondin 6% të bllok-ndihmës ekonomike. Fondi për këto familje është **345,770 (treqind e dyzetëpesë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë)** lekë.
2. Lista e familjeve të cituara në pikën 1 të këtij vendimi paraqitet në relacionin bashkëlidhur dhe është pjesë e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë**.

N/KRYETAR KËSHILLI

MUNIR SHEHU

